



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

**Mars , 2017**

Manifestim madhështor për nder të 7 Marsit- Ditës së mësuesit

**Respekt i lartë për pishtarët e pensionuar të dijes**



Edhe në fillimin e marsit të vitit 2017 Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës për nderë të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe shkollës shqipe, ka organizuar ceremoninë festive të ndarjes së mirënjohjeve dhe orëve të dorës pensionistëve të arsimit nga e tërë Kosova. Kanë shprehur respektin për punën e madhe të 560 pensionistëve të arsimit me pjesëmarrjen e tyre në këtë Manifestim Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, Zëvendësministri i MASHT-it, Mevlidin Krasniqi, drejtorë nga DKA-të e Kosovës dhe mysafirë të tjerë të nderuar. Mysafirë të veçantë të këtij. .... (faqe 4)

Realizim me sukses i Planit Strategjik 2015-2019

**Prezantime të denja të SBASHK-ut edhe në forume ndërkombëtare sindikale**



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përfaqësuar sindikatën tonë në mënyrë të dinjitetshme në tri takime të ndara ndërkombëtare... (faqe 5)

Tri ligje të rëndësishme për gjithë të punësuarit në Kosovë

**Gatishmëri e sinqertë e SBASHK-ut për dialog me institucionet**

Të gjithë edhe publikisht po e thonë se ishte vendimtar angazhimi me kohë i SBASHK-ut për tërheqjen nga ana e Qeverisë ....(faqe 8)

*Intervistë me profesorin e asocuar të Universitetit të Prishtinës, z.Atdhe Hykolli*

**Profesor Atdheu u gëzohet arritjeve të vazhdueshme të SBASHK-ut**

Atdhe Hykolli është profesor i asocuar në Fakultetin Edukimit. Me punë e përkushtim ka arritur të gëzojë respekt të lartë ... (faqe 3)

SBASHK-u i kushton rëndësi të veçantë kapaciteteve njerëzore për dialog

**Trajnim me të zgjedhurit e ri nga nivelet komunale e të shoqatave sindikale**



Pasi që SBASHK-u ka paraparë në Planin strategjik se njëra nga detyrat më të rëndësishme është përgatitja e veprimtarëve ... (faqe 7)



## Editorial

### Mësuesi dhe shkolla nëpër vite e dekada

Në fillim të çdo marsi kudo flitet e shpalosen kujtimet për shkollën shqipe dhe për mësuesin. Cili do nga ne spontanisht kthehet nëpër kohë e vite dhe kujton fillimisht ditët e fëmijërisë. Kujton vitet e kaluara në bankat shkollore dhe i duket se po dëgjon zërin e ëmbël të mësuesit. Në dekadat e shkuara ne si fëmijë kur ishim e donim shkollën dhe kishim respekt të lart për mësuesin a mësuesen tonë. Këtë respekt te ne e shtonin edhe fjalët e zgjedhura të prindërve tanë. Më kujtohen rastet kur fjaloseshim e përplaseshim ndonjë herë me nxënës të klasës tjetër nëse ata e thoshin edhe një fjalë të keqe për mësuesen tonë. Krahas prindërve, mësuesi ishte personaliteti më i dashur për ne gjithë ato vite e dekada.

Këta pishtar të diturisë u dëshmuar me punë e sakrificë. Këta njerëz me zemër të madhe u bënë fole për shkronjat dhe gjuhën e kulturën e bukur shqipe dhe i mbrojtën ato nga furtunat e pushtuesit.

A është edhe sot e gjithë ditën kështu? Fatkeqësisht jo. Individ e grupe për qëllime personale po mundohen ta lëndojnë personalitetin dhe emrin e madh MËSUES. Flasin pa as edhe një argument keq duke u krekosur e duke menduar se po thonë diçka të mençur. Ata janë nxitës të individëve të tjerë që duan të qojnë dorë mbi mësuesin dhe shkollën. Pushtuesi nuk e rrënoi dot shkollën shqipe dhe gjuhën tonë, kurse këta njerëz kanë hyrë në vallen e hijeve të zeza dhe me intriga e gënjeshtër mundohen ta lëndojnë shëmbëlltyrën e mësimdhënësve. Prandaj, kolegë e kolege kudo jeni ju lus për kujdes. Mos bini pre e momenteve të inskenuara .

Vazhdoni ta ruani taktin pedagogjik dhe punoni si kurrë me par me përkushtim. Me unitet e me arritje të reja do ua mbyllim gojën hijeve të zeza dhe do ta ruajmë emrin e madh të mësuesit dhe shkollës shqipe.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotet në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

Intervistë me profesorin e asocuar të Universitetit të Prishtinës, z.Atdhe Hykolli

### Profesor Atdheu u gëzohet arritjeve të vazhdueshme të SBASHK-ut



*Atdhe Hykolli është profesor i asocuar në Fakultetin Edukimit. Me punë e përkushtim ka arritur të gëzojë respekt të lartë nga kolegët dhe nga*

*anëtarësia e SBASHK. Ai shprehet mirë që është anëtar i SBASHK-ut dhe apelon të kolegët e tij në UP që, ende nuk janë pjesë aktive e SBASHK-ut që të anëtarësohen sepse, si thotë Atdheu, të jenë me ne bashkë e në SBASHK.*

#### Arsimimi Sot:

Kush është Atdhe Hykolli?

#### Hykolli:

Jam i lindur ne 1972 ne Sllatinë të madhe. Shkollën fillore e kam kryer aty. Te mesmen , universitetin edhe shkollimin e lartë në Prishtinë. Momentalisht jam profesor i asocuar ne fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës.

#### Arsimimi Sot:

Jeni anëtar I SBASHK-ut. Si e vlerësoni aktivitetin e kësaj sindikate në fakultetin tuaj?

#### Hykolli:

Po jam i anëtar i SBASHK-ut në fakultetin e Edukimit. Ndjem mirë që kolegët më kanë besuar të jem nënkryetar i SBASHK-ut në këtë fakultet. Sindikata mbron interesat e punëtorëve, është e pavarur prej partive politike dhe i mbron interesat e profesorëve dhe administratës. Gëzohem kur shoh nga afër se si SBASHK-u nuk pushon se vepruari për të realizuar kërkesat e anëtarësisë dhe është kënaqësi kur raportet tregojnë se çdo muaj shtohet numri i anëtarëve të sindikatës sonë.

#### Arsimimi Sot:

E përcillni me kujdes çdo aktivitet të SBASHK-ut, I cili është vlerësimi juaj për arritjet e SBASHK-ut?

#### Hykolli:

SBASHK është e vetmja organizatë në Kosovë që mbron punëtorët e arsimit dhe gjithmonë iu del përballë kërkesave të tyre dhe për këtë arsye kam kënaqësinë edhe unë që jam pjesë e saj. SBASHK-u është shembulli më i mirë i një sindikate të organizuar e unike që i kushton rëndësi të madhe dialogut dhe insiston që në takime me institucionet përmes dialogut të zgjedh çështjet e ngritura, por po ashtu SBASHK-u është dëshmuar se di të lëvizë fuqishëm në mbrojtje të kërkesave kur dialogu nuk jep rezultate të pritura.

#### Arsimimi Sot:

SBASHK-u po prezantohet me sukses edhe në takime ndërkombëtare sindikale. Cila është e veçanta e këtyre aktiviteteve?

#### Hykolli:

Kjo është me rëndësi të veçantë për arsye se SBASHK-u përfaqësohet në mënyrë të barabartë me të gjitha sindikatat botërore. Duke qenë në takime ndërkombëtare përfaqësuesit tanë marrin përvojat nga pjesëmarrësit e tjerë , por edhe tregojnë për përvojat dhe arritjet e shumta të sindikatës sonë duke i bërë të njohura këto arritje e përvoja kudo te shtetet ve botës.

#### Arsimimi Sot:

Ishit në Bruksel për ta përfaqësuar SBASHK-un në Komitetin ETUCE për Arsim të Lartë dhe Hulumtim. Ju lusim për përshtypjet tuaja nga atje?

#### Hykolli:

Kemi krijuar kontakte , përvoja te ndryshme dhe kështu që kemi pas mundësi qe edhe ne ti shprehim mendimet tona ne mesin e te gjitha sindikatave pjesëmarrësve në ETUCE. Një takim i tillë kishte vlerë edhe ngase unë fola për arritjet e sfidat e SBASHK-ut dhe krijova ura reja të miqësisë e bashkëpunimit. Besoj se në të ardhmen edhe në shtetin tonë do të organizohen takime ndërkombëtare sindikale nga ETUCE dhe ne do të dalim faqebardhë sepse dimë të organizojmë takime të mëdha dhe të gjithë e dinë edhe për mikpritjen që është traditë e njohur jona.

## Arsimimi Sot:

Çfarë duhet përmirësuar në arsimin e Kosovës, me qëllim që të shënohen rritje edhe më të mëdha?

## Hykollli:

Ndoshta në arsimin e Kosovës të shihet perspektiva e punonjësve të arsimit, duhet t'u epet mundësi më e madhe për veprimtaritë e tyre ngase janë ekspert në këtë punë, mos të ketë ndërhyrje të grupeve të interesit. Mendoj se me një angazhim të përbashkët të të gjithëve gjendja në arsim do të përmirësohet çdo ditë e më shumë dhe me këtë do të kemi edhe ngritje të vazhdueshme të cilësisë.

## Arsimimi Sot:

Në një takim me kolegët tuaj, çfarë do t'u thoshit për SBASHK-un?

## Hykollli:

Bashkohuni me SBASHK-un sepse është e vetmja sindikatë e arsimit që i mbron të drejtat e punëtorëve të arsimit pa dallim. Kjo sindikatë po forcohet vazhdimisht dhe po bëhet e respektuar kudo në vend dhe në botë sepse angazhohet me përkushtim dhe në të vërehet lehtë fryma demokratike. Në SBASHK dëgjohet zëri i anëtarësisë dhe kjo është vlerë e kësaj sindikate. Mendoj se në të ardhmen edhe një pjesë e profesorëve të Universitetit të Prishtinës, që ende nuk janë pjesë aktive të SBASHK-ut të jenë me në bashkë e në SBASHK.

## Gjatë muajit

### Manifestim madhështor për nder të 7 Marsit- Ditës së mësuesit **Respekt i lartë për pishtarët e pensionuar të dijes**



Edhe në fillimin e marsit të vitit 2017 Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit dhe shkollës shqipe, ka organizuar ceremoninë festive të ndarjes së mirënjohjeve dhe orëve të dorës pensionistëve të arsimit nga e tërë Kosova. Kanë shprehur respektin për punën e madhe të 560 pensionistëve të arsimit me pjesëmarrjen e tyre në këtë Manifestim Ministri i



Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, Zëvendësministri i MASHT-it, Mevlidin Krasniqi, drejtorë nga DKA-të e Kosovës dhe mysafirë të tjerë të nderuar. Mysafirë të veçantë të këtij aktiviteti solemn ishin edhe mësimitdhënësi Agim Hasani nga Medvegja dhe Ali Daci nga Dacajt e Rozhajës.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj kujtoj se këto mirënjohje janë në shenjë respekti për këta pishtarë të dijes të cilët patën ditë të lumtura por edhe ditë me plot sfida në arsim.

“Ndriçuat rrugën tonë të arsimit dhe ri-ngritjes tonë kulturore, puna juaj frymëzoi idealizmin, sakrificën për liri dhe dijen, sakrifica juaj frymëzoi breza të tërë për liri dhe pavarësi. Ju e mbajtët gjallë misionin e



shkollës shqipe, frymëzimin për sakrificë sepse nuk ka sakrificë që nuk ia vlen për hapjen e dijes dhe mësimit. Sot ne i kujtojmë të gjithë ata mësues e mësuese që nuk janë në mesin tonë, ata që dhanë jetën e tyre dhe vetë mohuan për ri-ngritjen e këtij populli”, ka thënë

Abrashi, “Sot ne duhet të zëmë hapin me botën e zhvilluar, sot na duhen studiues të shkencave sociale dhe humane, por më shumë na duhen inxhinierë, teknologë na duhen profesionistë”, ka shtuar në fjalën përshëndetëse Ministri Arban Abrashi, kurse zëvendësministri i MASHT-it, Mevlidin Krasniqi është shprehur se shkolla e pati fatin e njëjtë sikurse ajo e kombit.

“Këtë Mars shënojmë 130 vjetorin e jetës së shkollës shqipe, kjo ditë shënon festën e përbashkët kombëtare në tërë hapësirën shqiptare, ditë që shënon rrugëtimin e gjatë e shkollës shqipe, rrugëtimin që nuk ishte aspak i lehtë. Shkolla jonë pati fatin e kombit tonë, historia e saj është vet historia jonë”, kujtoi zëvendësministri Krasniqi.



Edhe drejtoresha e DKA-së së Prishtinës, znj. Arbërie Nagavci ka përshëndetur këtë ngjarje me rëndësi për arsimin shqip. Ajo ka shprehur respekt të lartë për pensionistët që ishin sallën e Pallatit të rinisë, duke

kujtuar se ata me vite e dekada kanë punuar për arsimimin dhe edukimin e brezave.



Në pjesën e dytë të Manifestimit të gjithë të pensionuarit nga marsi i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti, SBASHK –u i nderoi me mirënjohje dhe me nga një orë dore



Realizim me sukses i Planit Strategjik 2015-2019

## Prezantime të denja të SBASHK-ut edhe në forume ndërkombëtare sindikale



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përfaqësuar sindikatën tonë në mënyrë të dinjitetshme në tri

takime të ndara ndërkombëtare.

Është fjala për takimin e Komitetit për Arsim të Lartë dhe Hulumtim, organizuar nga ETUCE më 14 e 15 mars, në të cilin përfaqësuesi i SBASHK-ut, prof.

# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Atdhe Hykolli ka lënë përshtypje të mira dhe ka dëshmuar se SBASHK-u ka njohuri të larta sindikale dhe se di të shpreh e të dëshmojë këto njohuri, jo vetëm në nivel vendi, por edhe në takimet ndërkombëtare. Hykolli për dy ditë të angazhimeve në Komitetin gjegjës ka krijuar miqësi të reja duke shtuar bashkëpunimin e sindikatës sonë me sindikatat simotra nga e tërë Evropa.




Një prezantim të denjë të SBASHK-ut ka bërë edhe përfaqësuesi Ymer Ymeri në Takimin e organizuar nga Internacionalja Botërore e Arsimit më 13 e 14 mars me temën kyçe “Kushtet e punës dhe cilësia në arsim”. Takimi është mbajtur në Bruksel dhe në të kanë marrë pjesë 76 sindikata nga vende të ndryshme të botës. Përfaqësuesi i SBASHK-ut në paraqitjet e tij ka informuar kolegët sindikalistë nga të 76 shtetet për arritjet, sfidat dhe angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut.



Në këtë takim i është dhënë hapësirë meritore edhe kontratave individuale të punës në sektorin e arsimit. Përfaqësuesi i SBASHK-ut ka sjellë shembuj të mirë në këtë punëtori sepse fal angazhimit të SBASHK-ut dhe mirëkuptimit të MASHT-it të punuarit në arsimin e Republikës së Kosovës marrin kontrata individuale

në kohë të pacaktuar pas një viti përvojë të punës nëse janë në vendet e tyre adekuat, kanë kualifikim adekuat dhe kanë se paku 10 orë mësimore në lëndën për të cilën kanë diplomuar.




Edhe në një takim tjetër të rëndësishëm të organizuar nga ETUCE në Bruksel ka marrë pjesë SBASHK-u.



Është fjala për takimin lidhur me Barazinë, që është mbajtur më 20 e 21 mars. Në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare SBASHK-un e ka përfaqësuar Vlora Rexhepi Berisha. Ajo krahas angazhimit dhe kontributit në tryezat dhe grupet e punës ka zhvilluar edhe takime me udhëheqëse të ETUCE dhe me përfaqësues të sindikatave të shumta nga e tërë bota.





Këto takime kanë rezultuar me gatishmërinë e zyrtarëve të ETUCE dhe të përfaqësuesve të sindikatave të ndryshme për të shtuar bashkëpunimin me SBASHK-un. Kështu po realizohet me përpikëri Plan i strategjik i SBASHK-ut 2015-2019 edhe për pjesën që ka të bëjë me forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

SBASHK-u i kushton rëndësi të veçantë kapaciteteve njerëzore për dialog

## Trajnim me të zgjedhurit e ri nga nivelet komunale e të shoqatave sindikale

Pasi që SBASHK-u ka paraparë në Planin strategjik se njëra nga detyrat më të rëndësishme është përgatitja e veprimtarëve sindikalë për dialog të suksesshëm social, ka nisur me agjendën e trajnimeve të të zgjedhurve të ri për forcimin e kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social.



Ky aktivitetet ka nisur më 24 mars dhe në të janë përfshirë të zgjedhurit e ri në shoqata sindikale e në nivel komunal nga Mitrovica, Vushtrria, Prishtina, Kastrioti (Obiliqi), Suhareka, Rahoveci e Lipjani.



Gjatë trajnimit 3 ditor trajneri i licencuar për dialogun social, Ymer Ymeri, i ndihmuar nga kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj kanë treguar me shembuj konkret se cili është përkufizimi për dialogun social, me funksionin dhe sfidat që dalin gjatë



dialogut social. Pjesëmarrësit pastaj kanë dhënë opinionet e tyre lidhur me dialogun social për të marrë edhe shembuj nga përvoja e tyre, qoftë në nivel shkollë apo në nivelin komunal të dialogut. Trajneri Ymer Ymeri ka mundur që ky aktivitet të zhvillohet në formë të bashkëbisedës dhe prandaj ishte i madh interesimi dhe angazhimi konkret i pjesëmarrësve.



bashkëbisedës dhe prandaj ishte i madh interesimi dhe angazhimi konkret i pjesëmarrësve.

Pjesë e veçantë e trajnimit ishte puna në grupe, që ka sfiduar pjesëmarrësit të saktësojnë se në dialog cilat janë interesat e punëtorëve, cilat janë të punëdhënësit dhe cilat janë interesat e përbashkëta. Kjo pjesë e trajnimit është përcjellë me interesim të veçantë dhe

janë shoqëruar edhe me debate e bashkëbiseda të shumta me qëllim që të arrihet pajtueshmëri mes grupeve për çështjet e cekura gjatë punës në grupe.

Gjatë tri ditëve të trajnimit janë shpalosur edhe tema e çështje të tjera të rëndësishme që ndihmojnë në forcimin e kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social.

Tri ligje të rëndësishme për gjithë të punësuarit në Kosovë

## Gatishmëri e sinqertë e SBASHK-ut për dialog me institucionet

Të gjithë edhe publikisht po e thonë se ishte vendimtar angazhimi me kohë i SBASHK-ut për tërheqjen nga ana e Qeverisë e Projektligjit për pagat, i cili kishte marrë dritën e gjelbër dhe po nisej për procedurat e votimit në Parlament. Ky veprim i Qeverisë ka bërë që të krijohet një moment i ri për dialog mes sindikatave dhe përfaqësuesve të institucioneve të shtetit tonë. Duke u nisur nga fakti se është dëshmuar se ka gatishmëri të sinqertë për dialog me institucionet, i është dërguar ftesë publike Kryeministrit Mustafa pikërisht për dialog dhe arritje të marrëveshjeve të drejta e në shërbim të anëtarësisë.



“I nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa Ju dhe tërë opinioni e dini se SBASHK-u me të drejtë kishte reaguar ndaj Projektligjit për pagat duke e konsideruar atë si

degradues e nënçmues për të punësuarit në sektorin e arsimit. Në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe me MASHT-in ne kemi dhënë propozimet tona të argumentuara me fakte lidhur me ndryshimet në këtë Projektligj dhe jemi të sigurt se

ato do të përfillen. I nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa me tërheqjen që i keni bërë Projektligjit për pagat është krijuar një moment i ri dhe i mirë për dialog korrekt e përmbajtjesor mes Ministrive gjegjëse dhe SBASHK-ut e Sindikatave tjera në mënyrë që me një angazhim të përbashkët e përmes dialogut konstruktiv të bëhen të pranueshme për të gjitha palët përmbajtja e Ligjit për pagat dhe të Ligjit të punës e atë atij për shërbyesit civilë e publikë. Një dialog i tillë do të mundësonte që të dy palët, pra Qeveria dhe SBASHK-u e sindikatat tjera të ofrojnë propozime të bazuara në fakte e argumente dhe të arrihej pajtueshmëri për përmbajtjen e këtyre tri ligjeve, që janë shumë të rëndësishme për gjithë të punuarit në sektorin publik, por edhe në atë privat”, thuhet në ftesën publike të SBASHK-ut për dialog drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Isa Mustafa. “I nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, SBASHK-u i drejtohet me këtë ftesë publike Kabinetit Qeveritar për dialog të sinqertë e korrekt në mënyrë që të gjejmë zgjidhje të pranueshme për çështjet konkrete, pa pasur nevojë për përplasje e veprime sindikale”, e ka kujtuar SBASHK-u Kryeministrin Mustafa.



Të 128 marrëveshjet me bizneset për zbritje çmimesh të shërbimeve

## Mundësi e mirë për të ndihmuar buxhetin familjar

Edhe pse është pensionuar, veprimtari sindikal Sadik Shala vazhdon të angazhohet në shërbim të anëtarësisë. Ai sa ishte kryetar i Kuvendit të SAF e SAM të Suharekës ishte dalluar me arritjen e marrëveshjeve me biznese e institucione private shëndetësore për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët e SBASHK-ut. Edhe para pak ditësh Sadiku arriti edhe një marrëveshje për zbritje çmimesh e kësaj radhe me Barnatoren “Vjosa



Farm” në Suharekë. Marrëveshja mundëson që anëtarët e SBASHK-ut në këtë barnatore të marrin medikamente me zbritje çmimesh prej 10 %.

Apelojmë të anëtarët e SBASHK-ut që të shfrytëzojnë mundësinë që ua ofrojnë 128 marrëveshjet e nënshkuara deri tani sepse kjo është një mundësi e mirë për të ndihmuar e ruajtur buxhetin familjar.